



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 2400/11 prot.,

Datë 04.11.2025

V E N D I M
Nr. 1601/2025

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Anila Malaj	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 04.11.2025 shqyrtoi ankesën me:

Objekt: Mbi zbatimin e vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 1393/2025, datë 06.10.2025 për procedurën e prokurimit prokurimit “E Hapur - Mallra”, me Nr. REF-57080-08-04-2025, me objekt: “Blerje materiale mjekimi të përgjithshme, konsumi dhe kirurgjikale për nevojat Spitalore, ndarë në 2 (dy) lote”, Loti Nr.2: “Blerje materiale mjekimi konsumi dhe kirurgjikale” me Nr. REF-57084-08-04-2025 me fond limit 5,000,000 (pesë milion) lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 20.08.2025 na autoriteti kontrktor, Drejtoria e Spitalit Rajonal Dibër

Ankimues: BOE “EUROMED” SHPK me Nipt K71718012P dhe adresë Bulevardi “Bajram Curri”, pranë Marternitetit të ri, Tiranë

&

”O.E.S. Distrimed” SHPK me Nipt K31520054N dhe adrese Rruga “Nikollë Kaçorri”, Tiranë

Autoriteti Kontraktor: Drejtoria e Spitalit Rajonal Dibër
Adresa Rruga “Donika Kastrioti”, Peshkopi

Baza Ligjore: Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e

rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi dokumentacionin e çështjes dhe e diskutoi në tërësi,

Vëren:

I

Rrethanat e çështjes

I.1. Në datë 06.10.2025, Komisioni i Prokurimit Publik mori vendimin Nr. 1393/2025, ku vendosi:

[.....]

1. *Të mbylljë çështjen për pjesën e pranuar të ankesës së BOE “Euromed” SHPK & “O.E.S. Distrimed” në procedurën e prokurimit “E Hapur - Mallra”, me Nr. REF-57080-08-04-2025, me objekt: “Blerje materiale mjekimi të përgjithshme, konsumi dhe kirurgjikale për nevojat Spitalore, ndarë në 2 (dy) lote”, Loti Nr.2: “Blerje materiale mjekimi konsumi dhe kirurgjikale” me Nr. REF-57084-08-04-2025 me fond limit 5,000,000 (pesë milion) lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 20.08.2025 na autoriteti kontrktor, Drejtoria e Spitalit Rajonal Dibër*
2. *Të pranojë ankesën e BOE “Euromed” SHPK & “O.E.S. Distrimed” në procedurën e prokurimit “E Hapur - Mallra”, me Nr. REF-57080-08-04-2025, me objekt: “Blerje materiale mjekimi të përgjithshme, konsumi dhe kirurgjikale për nevojat Spitalore, ndarë në 2 (dy) lote”, Loti Nr.2: “Blerje materiale mjekimi konsumi dhe kirurgjikale” me Nr. REF-57084-08-04-2025 me fond limit 5,000,000 (pesë milion) lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 20.08.2025 na autoriteti kontrktor, Drejtoria e Spitalit Rajonal Dibër*
3. *Autoriteti kontrktor të anulojë vendimin e KVO-së mbi skualifikimin e bashkimit të operatorëve ekonomikë ankimues “Euromed” SHPK & “O.E.S. Distrimed”, duke e kualifikuar atë.*
4. *Autoriteti kontrktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.*
5. *Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga BOE “Euromed” SHPK & “O.E.S. Distrimed”.*

6. *Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.*

7. *Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.*

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.” [...]

I.2. Me shkresën nr. 903/1prot., datë 14.10.2025, protokolluar me tonën nr. 2400/8 prot., datë 03.11.2025, autoriteti kontraktor Drejtoria e Spitalit Rajonal Dibër, njofton se ka zbatuar vendimin e KPP-së Nr. 1393/2025 datë 06.10.2025 duke i bashkëngjitur shkresës Formularin e Njoftimit të Fituesit.

II

Komisioni i Prokurimit Publik

Pasi shqyrtoi dokumentacionin e mësipërm,

Arsyeton

II.1. Me shkresën nr. 903/1prot., datë 14.10.2025, protokolluar me tonën nr. 2400/8 prot., datë 03.11.2025, autoriteti kontraktor Drejtoria e Spitalit Rajonal Dibër, njofton se ka zbatuar vendimin e KPP-së Nr. 1393/2025 datë 06.10.2025 duke i bashkëngjitur shkresës Formularin e Njoftimit të Fituesit.

II.2. Nga verifikimi i raportit të auditit në sistemin e prokurimit elektronik, si dhe dokumentacioni i dërguar nga autoriteti kontraktor, KPP konstaton se autoriteti kontraktor ka kryer rivlerësimin e procedurës në sistemin e prokurimit elektronik duke kualifikuar BOE “Euromed” SHPK & “O.E.S. Distrimed SHPK” në përputhje me vendimin e KPP Nr. 1393/2025, datë 06.10.2025

Përsa më sipër, mbështetur në nenet 30, 115 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimin e Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Nenin 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të lejojë autoritetin kontraktor për vijimin me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit “E Hapur - Mallra”, me Nr. REF-57080-08-04-2025, me objekt: “Blerje materiale mjekimi të përgjithshme, konsumi dhe kirurgjikale për nevojat Spitalore, ndarë në 2 (dy) lote”, Loti Nr.2: “Blerje materiale mjekimi konsumi dhe kirurgjikale” me Nr.

REF-57084-08-04-2025 me fond limit 5,000,000 (pesë milion) lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 20.08.2025 na autoriteti kontrktor, Drejtoria e Spitalit Rajonal Dibër.

2. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Anila Malaj

Nënkryetar
Fiorent Zguro

Anëtar
Gjergj Mersini

